



## EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 24.06.2014, e cila filloi në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci, Sami Hamiti, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Sokol Krasniqi, Bekim Gashi, Naime Osmani, Vjollca Dibra - Ibrahim, Vlora Dumoshi, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Abit Kastrati, Shiqeri Spahiu, Sylejman Pireva, Genc Sherifi, Puhie Demaku, Hatixhe Hoxha, Qendron Kastrati, Ylli Hoxha, Hatixhe Latifi – Pupovci, Fisnik Ismajli, Teuta Krasniqi, Sadri Ramabaja, Lirak Çelaj, Memli Krasniqi, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Lirijeta Rexhepi, Laura Zherka, Remzi Pacolli, Islam Pacolli, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Rita Begolli, Imer Rusinofci, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa dhe Nenad Miladinoviqi.

**Munguan:** Blerand Stavileci, Shaip Shabani, Visar Arifaj dhe Cuneyd Ustaibo.

**Morën pjesë edhe** drejtorët e drejtorive të Komunës, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieve të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të OSBE-së dhe përfaqësues të KFOR-it.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues i Kuvendit.

**Kryesuesi** hapi diskutimin për pikat e rendit të ditës.

**Agim Gashi** tha se në këtë rend dite është dashur të jetë një informatë rreth dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në komunën e Prishtinës.

Për informatën lidhur me dëmet e shkaktuara nga vërshimet në komunën e Prishtinës, **Kryetari** tha se dëmet janë vlerësuar diku mbi gjysmë milioni euro dhe pasi që të kompletohem me informata të sakta, kjo do të silltet në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

**Lirak Çelaj** propozoi që Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ dhe Propozimi për ndryshimin e Rregullores për tarifën, ngarkesa dhe gjoha komunale, të hiqen nga rendi i ditës, me arsyetimin se duhet të plotësohen edhe më tej. Në këtë rend dite është dashur të futet edhe rishikimi i buxhetit dhe një informatë lidhur me arsimin. Sa i përket çështjes së arsimit, nuk pajtohemi me parimin e kufizimit të numrit të nxënësve, për shkak se nuk janë kushtet që ne t'i lëmë nxënësit në rrugë.

Do të duhej të ishte edhe një informatë për rrethrotullimin në Veternik.

Për Ditën e Çlirimit të Prishtinës, është bërë shumë pak rreth organizimit për manifestimin e kësaj dite, prandaj mendoj që është dashur kjo ditë të trajtohet më mirë, por shpresoj që vitin tjetër ta ketë trajtimin e duhur.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga z. Çelaj, **kryetari** dha sqarimet e nevojshme.

**Shefki Gashi** kërkoi nga drejtorja e Shërbimeve Publike, që shërbimet e kësaj drejtorie të jenë të barabarta në të gjitha pjesët e komunës, në mënyrë që të mos ketë ndarje, pra të bëhet dezinfektimi dhe dezinfektimi i ambientit, sidomos në shtratin e lumenjve, konkretisht në ato vende ku ka pasur vërshime.

Pyetja e dytë, për Drejtorin e Arsimit. A janë regjistruar nxënësit e komunës së Prishtinës në ato shkolla për të cilat po bëhet fjalë?

Për vizitën e Kryetarit të Komunës në Bullgari, kërkoi të dijë se ajo vizitë a ka qenë private apo institucionale.

**Sami Hamiti** tha se GP i LDK-së ka konstatuar se ka shumë vërejtje në Rregulloren për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ, dhe debati për këtë rregullore do të na merr shumë kohë. Kjo rregullore është e punuar dobët, andaj duhet të kthehet, të korrigojohet edhe një herë, të merren edhe vërejtjet e Grupit parlamentar të PDK-së dhe të LDK-së, pastaj në momentin e parë e kalojmë. Ne propozojmë që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës.

Të njëjtin mendim kemi edhe ndaj propozimit për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, që të hiqet nga rendi i ditës dhe të rishikohet edhe një herë.

**Ylli Hoxha** tha se Rregullorja për menaxhimin e varreza dhe objektit komemorativ dhe propozimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, kanë kaluar në Komitet për Politikë dhe Financa pa asnjë vërejtje të përfaqësuesve të LDK-së dhe nuk është kërkuar heqja e tyre nga rendi i ditës. Konsideroj se asamblistët, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, duhet të tregohen serioz karshi punëve të tyre dhe në momentin dhe vendin e duhur, t'i trajtojnë problemet ku duhet bërë, e jo ta sjellin Kuvendin në situatë jo të mirë, ta heqim një rend dite për të cilin janë zotuar.

**Agim Gashi** theksoi se arsyet e GP të LDK-së për heqjen e pikës së gjashtë nga rendi i ditës, janë për shkakun se përmbajtësish kjo rregullore nuk i plotëson nevojat për menaxhimin e varrezave në territorin e komunës së Prishtinës. Duhet të kemi një definim të qartë. Nëse është rregullore për menaxhimin e varrezave të qytetit të Prishtinës, duhet t'ia ndërroni titullin dhe t'i hiqni të gjitha pjesët tjera që implikon varrezat në territorin e komunës së Prishtinës. Nuk janë vetëm varrezat e qytetit të Prishtinës ato të cilat duhet t'i menaxhojë Komuna e Prishtinës, prandaj këtë duhet ta shtyjme dhe ta përpunojmë mirë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit rreth pikës së gjashtë dhe të nëntë të rendit të ditës, **Kryetari** tha se nëse nga rendi i ditës duam ta heqim një pikë, duhet pasur arsye procedurale, andaj propozoj që këtë çështje sot ta diskutojmë, t'i marrin qëndrimet e grupeve parlamentare, në mënyrë që herën tjetër ta hartojmë një rregullore sa më të mirë.

**Kimete Zeqa** propozoi që rendi i ditës të procedohet ashtu siç është dhënë, sepse pa diskutuar, pa sugjeruar, pa vërejtje, si mund të dalim prapë radhën tjetër në seancën tjetër.

**Hazir Borovci** u shpreh se ai kishte votuar për këtë rend dite në Komitetin për Politikë dhe Financa, për ta proceduar dhe diskutuar në Kuvend.

**Me shumicë votash, (23) njëzet e tri për, u konstatua se u miratua ky**

## REND I DITËS

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt;
2. Dhënia e betimit të anëtarit të ri të Kuvendit;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpik - Prishtina e Re;
4. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për objekt sporti - Rekreacioni ujqor publik i tipit të mbyllur;
5. Propozimi për dhënie e pëlqimit për ndryshimin e Planit rregullues të lagjes "Kalabria";
6. Propozimrregullore për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ;
7. Propozimrregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike;
8. Propozimrregullorja për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore;
9. Propozimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale;
10. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përcjelljen e procedurës për zgjedhjen e këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt**

**Lirije Avdiu** bëri vërejtje në ekstrakt, konkretisht për pikën e dhjetë, duke thënë se aty ku është diskutuar për raportet e ndërmarrjeve publike lokale, ne si Grup parlamentar, kemi pasur vërejtje dhe pyetje për gjithsecilën prej tyre dhe në këtë ekstrakt të procesverbalit nuk janë përfshirë ato, veçanërisht te ndërmarrja "Pastrimi" dhe ndërmarrja "Stacioni i Autobusëve". Kërkojmë që të bëhet ky përmirësim.

**Rita Begolli** bëri vërejtje në ekstrakt, lidhur me pikën e shtatë, duke thënë se diskutimi im nuk është përshkruar në ekstrakt, andaj kërkoj që kjo të korrigjohet.

**Shaip Hajrizi** bëri vërejtje për pikën e dhjetë të ekstraktit, duke cekur se pyetja e cila më është bërë nga Lirijeta Rexhepi, përgjigjen të cilën ia kam dhënë asaj nuk është përfshirë në ekstrakt, prandaj do të ishte mirë që kjo të korrigjohet.

Lidhur me ekstraktin e procesverbalit, **Kryesuesi** i njoftoi të pranishmit se nuk pajtohet që ekstrakti t'i ketë më se tridhjetë faqe dhe të përfshihet çdo diskutim në procesverbal, meqenëse incizohet dhe hartohet transkripti, i cili i përcillet secilit anëtar të kuvendit, ku paraqitet çdo diskutim i bërë në mbledhje. Kjo është çështje e Drejtorisë së Administratës, se një procesverbal prej 30 faqesh po më duket është i tepërt, por ne vendosim këtu si Kuvend. Tash e tutje, në ekstraktin e procesverbalit të përfshihen diskutimet që kanë të bëjnë pikërisht me pikën e rendit të ditës, dhe të përfshihen konstatimet, konkluzionet dhe vendimet, ngase e kemi transkriptin dhe nuk ka nevojë që në ekstrakt të procesverbalit të shënohet çdo fjalë nga diskutimet.

**Me vërejtjet e dhëna, me shumicë votash, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Kuvendit.**

**Pika e dytë**

**Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit**

**Shiqeri Spahiu**, anëtar i ri i Kuvendit, nga radhët e subjektit politik të LDK-së, bëri betimin para anëtarëve të Kuvendit.

**Pika e tretë**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpik - Prishtina e Re, Kryetari** i njoftoi të pranishmit rreth këtij propozimvendimi, i cikli tha se nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ka ardhur kërkesë për caktimin e lokacionit të Pallatit olimpik, ku do vendosen Komiteti Olimpik i Kosovës, Komiteti Paraolimpik dhe 35 federata të sporteve. Për këtë lokacion janë kërkuar rreth 20 arë tokë, andaj dhe kërkohet nga Kuvendi që ta miratojë këtë propozimvendim.

**Shiqeri Spahiu**, në emër të GP të LDK-së, tha se këtë material e kemi shqyrtuar dhe në parim e mbështesim këtë iniciativë. Në arsyetimin e këtij materiali janë bërë disa gabime teknike, të cilat duhet të përmirësohen, ose nuk është e sqaruar sa duhet. Në kopjen e planit, në fletën poseduese dhe në një orto-foto që është bashkangjitur në këtë material, ka disproporcion dhe ka disharmoni në mes të këtyre parcelave dhe asaj, gjë që ne e kemi në vendim dhe është e paraqitur. Parcela kadastrale nr. 547 është paraqitur si dy njësi, që mund të them se nuk mundën me qenë dy parcela me numër të njëjtë kadastral, andaj kjo duhet të përmirësohet. Si Grup parlamentar, e mbështesim këtë propozimvendim dhe e votojmë për miratim.

**Ylli Hoxha**, në emër të GP të LVV-së tha se edhe ne si Grup parlamentar, e mbështesim këtë propozimvendim dhe e votojmë për miratim.

**Memli Krasniqi**, në emër të GP të PDK-së, tha se edhe ne pa dyshim se e mbështesim kërkesën e Ministrisë për të pasur një objekt reprezentativ, i cili do të krijojë mundësi për

një funksionim më të dinjitetshëm, por edhe më normal, së paku të këtyre organizatave të rëndësishme sportive.

Ai shprehu dëshirën që ky vendim po përputhet edhe me shënimin e Ditës Olimpike, e cila është shënuar dje në Prishtinë me shumë aktivitete, por po përputhet edhe me hapjen e projekteve ideor që kanë konkurruar për Pallatin olimpik, i cili është mbajtur dje.

**Islam Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, e përkrahu këtë propozimvendim, por duke shprehur mendimin se hapësira ka mundur të jetë më e madhe, sepse është e nevojshme. Në këtë zonë mungon komplet infrastruktura, në veçanti ajo e ujërave të zeza, që është shumë e rëndësishme.

**Ymer Rusinovci**, në emër të GP të AAK-së, e mbështeti këtë nismë për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpik. Ai shprehu mendimin se për ndonjë specifikacion të mundshëm teknik që mund të pasojë më vonë, Drejtoria e Urbanizmit dhe gjithë dikasteret e udhëheqjes së Komunës, do të jenë përgjegjës për këtë.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të PD-së, tha se edhe ne do ta përkrahim këtë, me shpresën se kompetentët para se të fillojnë ta realizojnë këtë, do t'i verifikojnë ato sugjerime që u bënë këtu, posaçërisht rreth zgjerimit të hapësirës, nëse ka mundësi, që e propozoi z. Pacolli.

**Abetare Fazliu**, në emër të GP të LB-së, e mbështeti këtë vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpik.

**Shefki Gashi** theksoi se sipërfaqja e caktuar prej 20 arë nuk është e mjaftueshme për një destinacion të tillë, andaj nëse ndërtohet diçka e qëndrueshme, do të ishte mirë që kjo sipërfaqe të zgjerohet.

**Sylejman Pireva** theksoi se krahas ndërtimit të këtij objekti me salla, amfiteatër, restorant, do të ishte mirë që të mendohej edhe për një bibliotekë. Një koleksion me një përmbajtje të caktuar, i rëndësishëm për destinimin që mund ta ketë, do t'i shkonte mirë një objekti të tillë.

**Njëzëri u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Pallatit olimpik - Prishtina e Re;**

**Pika e katërt**

**Për Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për objekt sporti - Rekreacion uxor publik i tipit të mbyllur, Kryetar** tha se kemi të bëjmë me një projekt të ndërtimit të pishinës së mbyllur, andaj sa për fillimin e punëve nga buxheti janë ndarë 200 000 €. Ky projekt ka qenë i paraparë të ndërtohet në Gërmi, por ne nuk jemi pajtuar për atë lokacion, pasi që aty është dashtë të prehen shumë drurë, me të cilin veprim do të dëmtohej shumë ambienti. Ne kemi propozuar që lokacioni të jetë në lagjen "Arbëria", përballë Ambasadës amerikane. Për këtë propozim duhet të vendosim sa më shpejt, andaj dhe duhet ta diskutojmë.

**Vlora Dumoshi**, në emër të GP të LDK-së, tha se arsyetimi i dhënë nga Kryetari për ndërrimin e lokacionit për ndërtimin e këtij projekti, nuk qëndron, sepse një projekt i tillë nuk do ta kishte dëmtuar ambientin në Gërmi, aty kanë qenë e paraparë të prehen vetëm 3 - 4 drurë. Për këtë projekt ne fillimisht kemi bërë një studim shumë të madh edhe kemi vendosur të bëhet ky objekt në Gërmi për shumë arsye, për shkak të infrastrukturës, pra që të jetë një kompleks sportiv.

Mendoj se ne nuk do ta votojmë që projekti të zhvendoset në lagjen "Arbëria".

**Ylli Hoxha**, në emër të GP të LVV-së, tha se është shumë e arsyeshme që t'i kemi dy pishina, njëra në lagjen "Arbëria" dhe tjetra në Gërmi, sidoqoftë Prishtina ka nevojë për një pishinë të tillë, andaj dhe inkurajoj Kryetarin që të gjejë mjete alternative për të investuar sa më shpejt në Pishinën olimpikë.

**Laura Zherka**, në emër të GP të PDK-së, theksoi se për ndërrimin e këtij lokacioni, objekti në fjalë sipas planit rregullues, është paraparë të ndërtohet në afërsi të pishinës së Gërmisë, ku ne mendojmë se do të ishte shumë më mirë dhe më përshtatshëm të inkorporohej në atë lokacion, mirëpo bëhet ndërrimi i lokacionit dhe nuk na jepen më tepër alternativa. Mendoj se është dashtë të sqarohet se për të njëjtin objekt ekzistues a do duhet që edhe një herë të projektojmë, të kemi projekt të ri, apo mund të inkorporohet në Arbëri i njëjti objekt. Ky ndërrim i destinimit të sipërfaqeve pa u hartuar udhëzimet administrative në bazë të Ligjit për planifikim hapësinor në këto përmasa, nuk është shumë i lejueshëm, kështu që të kemi kujdes.

**Remzi Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se arsyeshmëria e paraqitur nga ana e Kryetarit rreth këtij projekti, duket të jetë e mangët, si çështja rreth financave, afateve për përfundimin e këtij projekti etj. Po ashtu është dashtë që të jetë shumë e saktë biseda rreth çështjes së Ambasadës amerikane, se mund të ndodhë prapë ndërrimi edhe i atij lokacioni.

Gjithashtu është dashtë të sqarohet se për të njëjtin objekt ekzistues a do të kemi projekt të ri, apo do të interpretohet projekti i mëparshëm.

Si GP këtë propozimvendim e përkrahim për miratim.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të PD-së, theksoi se edhe ne do ta përkrahim ndërtimin e këtij objekti, aq më tepër që ne jemi ithtarë të ruajtjes së gjelbërimit, në çoftë se me të vërtetë kjo tash mbetet përgjegjësi e atyre që i realizojnë këto projekte, pra kursehet gjelbërimi i Gërmisë. Sa i përket projekteve të tjera, a do të jetë e qëndrueshme këtu ku bëhet tash, apo nuk do të jetë, ne do të mbajmë rezervën - të drejtën që nesër, në qoftë se është gabim, do t'i kritikojmë ashtu si i përkrahim sot.

**Abetare Fazliu**, në emër të GP të LB-së, e përkrahu këtë vendim, duke shprehur mendimin se është shumë e nevojshme, pasi që në qytetin tonë deri tash nuk ka pasur ndonjë objekt të sportit dhe rekreacioni të tipit të mbyllur.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, **Kryetari** dha sqarime të nevojshme.

**Mustafë Krasniqi** u shpreh në përkrahje të ndërtimit të këtij objekti, por nuk e përkrahu ndërrimin e lokacionit që ishte i paraparë. Për këtë objekt ka projekt zbatues, prandaj nuk po e shohim të arsyeshme ta zhvendosim në lokacion tjetër, por le të planifikohet edhe ky objekt, t'i bashkohet pjesës tjetër në kompleksin e Gërmisë.

**Memli Krasniqi** theksoi se ky projekt origjinën e ka në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e jo nga Komuna e Prishtinës, i cili në vitin 2012 është i planifikuar në buxhetin e Ministrisë së Kulturës. Pra, duke marrë për bazë që Ministria e Kulturës pikërisht është ideatore e atij projekti, është e gatshme për bashkëfinancim, pra ne e kemi planifikuar dhe e kemi në kornizë afatmesme buxhetore.

**Agim Gashi** tha se sa i përket këtij projekti, nuk e di që ka pasur pengesa për bashkëpunim në mes Ministrisë së Kulturës dhe Komunes së Prishtinës, sepse nuk ka pasur ndonjë kërkesë nga Ministria e Kulturës. Sa i përket rrezes së sigurisë përreth parcelës së Ambasadës, mendoj se nuk do të ketë pengesa në atë aspekt.

**Flamur Shala** theksoi se caktim i këtij lokacioni, që tani po del se është i diskutueshëm, mund të bëhet edhe në Zonën ekonomike, ku Komuna e Prishtinës në vitin 2008, kishte caktuar lokacionin për ndërtimin e Qendrës sportive, që ishte projekt hungarez dhjetëra milionësh, në të cilën qendër ishin paraparë pesë pishina, madje edhe pishina olimpike dhe pishina të tjera përcjellëse, stadione etj., e që pengesë për këtë ndërtim ishte pikërisht Qeveria e Kosovës. Nëse projekti është që ne ta zhvillojmë sportin, pra përmes projekteve të tilla, atëherë ne mund të mendojmë edhe pak më shumë për caktimin e lokacioneve, sepse nuk është e thënë se a do t'i ndërtojmë në qendër, apo në periferi të qytetit, me rëndësi është që t'i plotësojmë kushtet për atë destinim.

**Lirak Çelaj** tha se ne jemi për të votuar këtë propozimvendim, pro ose kundër, por kur të thuhet me vërejtje, duhet ditur pak më specifikisht cilat vërejtje edhe çka thuhet në ato vërejtje.

**Me shumicë votash, me dy abstenime (Vlora Dumoshi dhe Naime Osmani), u miratua Vendimi për caktimin e lokacionit për Objekt sporti - Rekreacion uJOR publik i tipit të mbyllur.**

## **Pika e pestë**

**Lidhur me Propozimin për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e Planit rregullues të lagjes "Kalabria", Kryetari** i njoftoi të pranishmit rreth këtij propozimi për ndryshimin e planit rregullues, duke cekur se kanë mbetur edhe disa çështje teknike, të cilat duhet të rregullohen, e që nuk ka një përputhje momentalisht të këtyre gjërave me situatën në terren, gjë e cila dhe po pengon pastaj edhe në dhënien e lejeve. Ne kemi kërkuar që të bëhet një ndryshim i vogël teknik i një rruge, me qëllimin që qasja në rrethrotullimin, që është në ndërtim e sipër te "Temokosi", të jetë më e lehtë.

**Hysen Durmishi**, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale, tha se bëhet fjalë për disa ndryshime teknike shumë të vogla, në mënyrë që të mos presim derisa të kryhet revidimi i planit rregullues për lagjen "Kalabria", janë dy ndryshime që kërkohen të bëhen. Njëri ndryshim është në pjesën te lumi, ku tani aty ekziston rruga dhe tani duhet patjetër që të ndryshohet, në mënyrë që t'u mundësohet qytetarëve qasja nëpër infrastrukturën rrugore, dhe ky ndryshim ka të bëjë me një zhvendosje prej 5 m. Ndryshimi tjetër ka të bëjë me qasjen direkte të kësaj lagje në rrethrotullim, e cila deri më tani nuk ka pasur qasje direkte në rrugën Prishtinë - Shkup.

**Muhamet Selmani** ngriti shqetësim për rrugën e propozuar, dhe shtroi pyetjen: Sa do të jetë e përshtatshme ajo rrugë për atë lokacion, gjegjësisht në mes të banesave?

Lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Selmani, sqarime të nevojshme dha **Hysen Durmishi**, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

**Hatixhe Pupovci**, bëri vërejtje për materialin e prezantuar, konkretisht rreth vizatimeve grafike, duke cekur se herëve të tjera përpiluesit e skicave të jenë më të kujdesshëm, me qëllimin që sqarimet të jenë saktësisht më detale për një foto, e cila paraqet gjendjen ekzistuese dhe për një ndryshim, i cili tentohet të bëhet më tutje.

**Shefki Gashi** e përgëzoi angazhimin e Kryetarit dhe të drejtorit të drejtorisë përkatëse për intervenimin që duhet të bëhet në infrastrukturën rrugore, por kërkoi që të jepen lejet për ndërtim, të fillojnë punët, pasi që një numër i madh njerëzish kanë mbetur pa punë.

**Njëzëri u miratua Propozimi për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e Planit rregullues të lagjes "Kalabria".**

## **Pika e gjashtë**

**Për Propozimrregulloren për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ, të pranishmit i informoi Kryetari.** Ai tha se Rregullorja e cila është në fuqi, është shumë e mangët sa i përket menaxhimit të tanishëm të varrezave dhe nuk është në përputhje me realitetin e tanishëm, prandaj ideja ka qenë që ta përpilojmë një rregullore, që ta kemi një zgjidhje afatgjate.

Kjo rregullore trajton edhe Qendrën komemorativë, ku është e paraparë të jetë si morg, i cili tash për tash është jashtë përdorimit. Kemi menduar që me këtë rregullore të bëjmë një përputhje me gjendjen aktuale të pagesat, menaxhimi që bëhet nga Hortikultura, me rregulloren në fuqi, e mos të jemi në shkelje të rregullores aktuale, apo ta iniciojmë procedurën që këtë rregullore ta dërgojmë në diskutim publik për shqyrtimin e disa çështjeve. Edhe me Bashkësinë Islame jemi në biseda e sipër rreth disa çështjeve, si rivarrosja, ndërtimet me gurë mbi varreza etj. Për të gjitha këto çështje duhet të diskutojmë dhe të shihet mundësia se si të veprohet më tutje.

**Agim Saliu** tha se qëllimi është që të harmonizohet një pjesën e dispozitave të përgjithshme, në caktimin e çmimores për kryerjen e shërbimeve dhe lirim nga kryerja e këtyre shërbimeve.

**Agim Gashi**, në emër të GP të LDK-së, kërkoi që titulli i kësaj rregulloreje të definohet më qartë, të dihet se a është rregullore për menaxhimin e varrezave të qytetit të Prishtinës dhe objektit komemorativ që është afër, a është rregullore që përcakton rregullimin dhe menaxhimin e varrezave në territorin e Komunës së Prishtinës, ku përfshihen ndoshta edhe 60 apo 70 lokacione të tjera të vendbanimeve të ndryshme. Duhet ta precizojmë se çka po miratojmë, a po miratojmë rregullore për territor të komunës, apo për qytetin e Prishtinës, e pastaj lëshohemi në çështje të tjera detale.

Ai propozoi që neni 11 të hiqet, ose të riformulohet më mirë, po ashtu nenet 26, 36 dhe 50 duhet të riformulohen më qartë. Duke pasur parasysh të gjitha këto, ne duhet të ulemi edhe



një herë dhe t'i riformulojmë këto gjëra sa më qartë, në mënyrë që ta rregullojmë edhe sferën e varrezave nëpër fshatra, sepse ato kanë mbetur në një gjendje jo të mirë.

**Ylli Hoxha**, në emër të GP të LVV-së, tha se e përkrahim idenë e prezantuar nga Kryetari, se Prishtinës i duhet një debat shumë serioz mbi menaxhimin e varrezave të qytetit. Duhet të zhvillojmë një debat të thellë shoqëror lidhur me atë se çka do të bëjmë me varrezat e qyteti, andaj dhe e mbështesim këtë proces dhe konsiderojmë se duhet të ndodhë sa më parë. Duhet të fillojë edhe diskutimi publik, edhe hapat infrastrukturor investiv, të cilat e rregullojnë edhe pjesën tjetër të varrezave jashtë qytetit. Rregullorja duhet të na shërbejë për t'i menaxhua disa procese, të cilat do të ndodhin, andaj, nëse mundemi, sa më shumë ta qartësojmë këtë proces dhe ta institucionalizojmë, që të ecim më tutje, por, njëkohësisht edhe ta përmirësojmë në një debat cilësor.

**Lirak Çelaj**, në emër të GP të PDK-së, tha se ne në fillim kërkuam që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin se kjo nuk zgjidhet me amendamente. Në parim gjithë ajo që u diskutua deri më tani, duhet një debat më i gjerë edhe me komunitetin fetar, me shoqërinë civile dhe me secilin qytetar, pra kjo është çështje me rëndësi shumë të madhe.

**Remzi Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne propozojmë që të definohet një rregullore e plotfuqishme, edhe nëse na merr një periudhë kohore të caktuar, por të paktën kur ta përfundojmë një proces, ta kemi një zgjidhje afatgjate. Vërejtje bëri në nenin 54, duke dhënë propozimin që ky nen të jetë: *“Ndërmarrja për menaxhimin e varrezave, në bashkëpunim me komunitetin, t'i paraqesë ato rregulla, ndërsa tabelat njoftuese të vendosen nga ndërmarrja, në mënyrë që të jetë një format në të gjitha varrezat.*

Po ashtu propozoi që menaxhimin e varrezave ta bëjë Komuna e Prishtinës.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të AAK -LDD-së, tha se grupi ynë parlamentar konsideron se kjo rregullore duhet të shkojë në diskutim publik dhe të përfshihen të gjithë akterët, të japin kontributin që kjo rregullore të jetë afatgjate, e zbatueshme dhe e pranueshme për të gjithë qytetarët e komunës së Prishtinës.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të PD-së, tha se propozimrregullorja nuk ka dyshim se kërkon një analizë të gjithanshme dhe të gjerë. Partia e Drejtësisë nuk mendon që varrezat mund t'i menaxhojë vetëm kompania që di ta pastrojë qytetin, pa e inkorporuar sinqerisht dhe seriozisht kontributin e bashkësive fetare ekzistuese në Kosovë dhe në Prishtinë. Vërejtje bëri në nenin 1, ku propozoi që pas fjalës komunale, t'i shtohet fjala *“specifike”*; në nenin 3, aty pas shkurtesës NMV, t'i shtohet *“në bashkëpunim me bashkësinë fetare përkatëse”*; në nenin 10, që parasheh djegien e kufomës, kërkoi që të sqarohet më mirë; në nenin 16, po ashtu duhet të jetë *“organi kompetent të bashkëpunojë me komunitetin e bashkësisë fetare”*; në nenin 35, duhet t'i shtohet *“bashkëpunimi me komunitetin fetar”*. Vërejtje po ashtu bëri edhe në nenet 47 dhe 49. Me këto vërejtje dhe sugjerime, këtë propozimrregullore e përkrahim që të shkojë në diskutim të gjerë publik.

**Ibrahim Mehmeti** propozoi që në nenin 31, aty ku rregullohet çështja e çmimoreve për shërbimet rreth varrimit, me një pikë të veçantë në këtë nen, të rregullohet çështja e liritimit nga pagesa e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e ish-të burgosurve politikë, përderisa shumë komuna të tjera e kanë zgjidhur këtë çështje. Besoj që është e rëndësishme të merret seriozisht kjo kërkesë e jona dhe të miratohet.

**Sadri Ramabaja** theksoi se ne jemi dëshmitarë se varrezat nuk i kemi të nivelit që do të duhej t'i kishim. Jemi i vetmi kryeqytet pa varreza të mirëfillta, ku shkapërderdhja e tyre, përkujdesi etj. për kohë të gjatë i janë lënë stihisë. Sipas ligjit që është në hartim e sipër, si bashkësi fetare nuk do ta kemi vetëm Bashkësinë Islame, por edhe katër bashkësi të tjera brenda komunitetit shqiptar, kështu që varrezat e qytetit duhet të jenë të trajtuara drejtpërdrejt nga Komunës, që mirëmbajtja e tyre të jetë konform të gjitha bashkësive fetare. Ai propozoi që para se të dërgohet rregullorja për diskutim publik, ekzekutivi të krijojë një komision pak më specifik, jo vetëm prej juristëve, por të ketë edhe antropologë, teologë, sociologë dhe historianë, të cilët do të jepnin kontributin e tyre si profesionistë të atyre fushave. Pra, kjo është arsyeja pse kisha propozuar që gjithsesi të dërgohet në diskutim publik afatgjatë, të merret shumë më seriozisht dhe ky ekip paraprakisht ta trajtojë edhe një herë këtë rregullore, me gjithë ato vërejtje të cilat i bëra.

**Muhamet Selmani** e përkrahu plotësisht propozimin e Kryetarit, që të shkojë në debat më të gjerë. Gjithsesi këtu duhet të futen edhe mendimet dhe të merren edhe propozimet e bashkësive fetare.

Ai propozoi që Komuna t'i menaxhojë edhe varrezat e fshatrave, për arsye se është një çështje shumë e ndjeshme, sidomos rreth çështjes së pagesave, mënyrës së transportit, varrimit etj. Propozoi që të futet edhe një nen i veçantë për varrezat private, se ndoshta ka komunitet apo edhe shoqëri, apo familje, e cila ka edhe toka të veta që mund t'i planifikojë për varrezat private.

**Shefki Gashi** tha se kjo rregullore duhet të dërgohet në diskutim publik, për arsye se janë disa faktorë që duhet të japin mendimin, natyrisht janë qytetarët, institucionet, bashkësitë fetare dhe shoqëritë civile, për të pasur një rregullore që të mos lëndohen asnjëri prej tyre. Nuk qëndron ajo që thuhet nga z. Ramabaja, se varrezat e Prishtinës janë në gjendje katastrofale, përkundrazi, ato janë rregulluar, janë bërë disa rrugica, disa trotuare e disa gjëra të tjera që nuk kanë qenë më parë. Unë propozoj të parashihet një nen i veçantë, që gjatë ceremonisë së varrimit askush të mos hyjë në atë pjesën ku janë varret, pra të shfrytëzohet shtigjet ose pjesa tjetër ku është vendkalimi.

**Naime Osmani** u shpreh se varrezat e fshatrave nuk menaxhohen nga Hortikultura apo nga Bashkësia fetare, por menaxhohen nga vetë fshatarët.

Ajo kërkoi që kur të dërgohet kjo rregullore në diskutim publik, të kërkohet nga Bashkësia Islame që të përcaktojë një çmim për kryerjen e ceremonisë së varrimit, pra nga hoxha të bëhet selektimi i rasteve, apo të merren parasysh rastet sociale. Do të ishte mirë që Komuna ta bënte menaxhimin e varrezave në zonat rurale.

**Vlora Dumoshi** theksoi se kjo rregullore ka nevojë për një diskutim më të gjerë publik, se varrezat janë pasuri kombëtare e çdo vendi dhe është pasqyrë e një shteti.

Duhet të parashihet një nen për ndëshkime, për ata të cilët i dëmtojnë varrezat. Këtë e them mbi bazën e përvojës sime të hidhur, ku është vjedhur busti i babait tim. Kjo është një dukuri e shëmtuar dhe kryesit e veprave të tilla duhet të ndëshkohen.

**Sylejman Pireva** u shpreh se tash po bindem edhe më shumë se Kryetari kishte të drejtë që insistoi të diskutohet dhe të debatohet lidhur me këtë çështje. Ky kontribut konsideroj se është tepër me rëndësi dhe hap rrugën për debat më të gjerë publik.

Ai shprehu mendimin se roli i faktorit mjekësor shëndetësor do të ishte i rëndësishëm të përfshihet këtu, sepse mund të ndodh raste-raste, periudha të caktuara, të kemi njerëz të ngujuar edhe në karantinë për shkak të sëmundjeve, epidemive, që ne i kemi përjetuar vetë në vitet e 70-ta , dhe preferenca që mund të dali, d.m.th. nga komisioni shëndetësor a mjekësor, të merren parasysh që edhe ato të gjejnë vend dhe të përfshihen këtu.

**Remzi Pacolli** tha se varrezat në fshatin Hajvali i menaxhon xhamia e jo Hortikultura dhe xhamia e ka listën e veçantë të të gjitha shpenzimeve që i kryen gjatë varrimit, pra çdo varrim i qytetarit të Hajvalisë bëhet në bazë të listës që merret prej xhamisë së Hajvalisë.

**Kryetari** tha se në muajin shtator do të organizojmë dëgjimet publike të hapura me qytetarët, me bashkësitë fetare dhe me shoqërinë civile.

**U konstatua se me shumicë votash u përkrah propozimi që Propozimrregullorja për menaxhimin e varrezave dhe objektit komemorativ, të dërgohet në diskutim publik.**

**Pika e shtatë**

**Lidhur me Propozimrregulloren për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike, në pika të shkurtra informoi Kryetari.** Ai tha se me disa ndryshime të vogla, të cilat do t'i prezantojmë, besoj se mund të arrijmë një bashkëpunim në kalimin e kësaj rregulloreje.

**Sami Hamit**, në emër të GP të LDK-së, e falënderoi Kryetarin për shpjegimet, duke cekur se decidivisht është ajo çka u pajtuam, andaj konsideroj që është bërë mirë me këto ndryshime që u propozuan.

Me këto plotësime, GP i LDK-së këtë propozimrregullore e voton për miratim.

**Ylli Hoxha**, në emër të GP të LVV-së, u shpreh se jemi të gatshme t'i pranojmë këto kompromise të bëra me GP-në e LDK-së dhe të PDK-së. Këtë propozimrregullore e votojmë për miratim.

**Lirak Çelaj**, në emër të GP të PDK-së, theksoi se në parim, nëse bëhen ato ndryshime që u propozuan si GP, këtë propozimrregullore e përkrahim për miratim.

**Remzi Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne si GP, me të gjitha këto ndryshime që u propozuan, e përkrahim këtë propozimrregullore për miratim.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të AAK - LDD -së, e përkrahu për miratim këtë propozimrregullore, me ndryshimet dhe vërejtjet të cilat u cekën.

**Muhamet Selmani**, për vendosjen e antenave satelitore dhe për panot, shprehu mendimin se ai që aplikon, duhet ta ketë licencën nga ART-ja. Për vendosjen e aparatit të klimatizimit, subjektet duhet ta kenë edhe certifikatën e biznesit.

Lidhur me vendosjen e panove reklamuese, **Kryetari** dha sqarime shtesë.

**Agim Gashi** theksoi se në nenin 8 është harruar të përfshihet edhe kabina telefonike, me ç'rast propozoi që këtij neni ti shtohet edhe: *"kushtet dhe procedurat e vendosjes së kabinave telefonike"*. Ai shprehu mendimin se pas përfundimit të projektit të kogjenerimit në Prishtinë, Prishtina do të ballafaqohet me mihje të reja për vendosjen e sistemit të objekteve ku nuk kanë nxehje qendrore, andaj duhet të përfshihet edhe gypat e nxehjes qendrore.

**Sylejman Pireva** propozoi që vendosja e kontejnerëve të bëhet në vende të përshtatshme, në mënyrë që të mos vendosen para lokaleve ku konsumohet ushqimi. Do të duhej që inspekcioni ta rikontrollojë edhe një herë këtë gjendje dhe ta riorganizojë mënyrën e përshtatshme për rivendosjen e tyre.

**Me ndryshimet e dhëna, që ato të inkorporohen në tekstin final, njëzëri u miratua Rregullorja për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike.**

#### **Pika e tetë**

**Lidhur me Propozimrregulloren për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore, në pika të shkurtra informoi Kryetari. Ai tha se Ministria e Financave ka konstatuar se neni 7.2 duhet ndryshuar, pasi që nuk është në përputhje me një udhëzim administrativ.**

**Lirak Çelaj** tha se pikën d të nenit 2, pika 2.4 e diskutuam dhe kërkuam që të korrigohet, por ka mbetur e pakorrigjuar, andaj propozoj që pika d e këtij neni të jetë kështu: *“Federatat e regjistruara në Republikën e Kosovës dhe organizatat kulturore – edukative, të cilat ushtrojnë aktivitetet jo fitimprurës dhe që konsiderohen me interes publik”*.

**Agim Gashi** tha se në nenin 2, pika 2.3, në fund të fjalisë ku thuhet: *“vendimit të drejtorit të Drejtorisë së Arsimit”*, duhet të jetë: *“Vendimit të Komisionit të Drejtorisë së Arsimit”*.

**Jusuf Thaqi** theksoi se kjo rregullore e pamundëson shfrytëzimin e terreneve sportive në shkollat e fshatrave, andaj do të ishte mirë që të parashihej një nen, i cili do ta mundësonte shfrytëzimin e terreneve sportive pa pagesë.

**Remzi Pacolli** shprehu mendimin se duhet bërë një dallim mes terreneve sportive të qytetit dhe atyre të fshatrave.

**Mirlinda Sopi**, lidhur me çështjes e pagesës për shfrytëzimin e hapësirave sportive, u shpreh se nuk do të duhej të bëhej ky dallim mes fshatrave dhe qytetit.

**Me vërejtjet e dhëna nga z. Çelaj, që ato të inkorporohen në tekstin final, me shumicë votash, një abstenim, u miratua Rregullorja për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore.**

#### **Pika e nëntë**

**Lidhur me Propozimin për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale, të pranishmit i njoftoi Ardian Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.**

Ai tha se kemi propozuar që të ndryshohen disa tarifa, si në nenin 6, pika 6.9, që ka të bëjë me shfrytëzimin e hapësirave para objektit ku kryhen shërbimet tregtare dhe hoteliere. Më herët ka qenë vetëm sezoni veror si tarifë dhe nuk kanë mundur të shfrytëzohen gjatë dimrit. Ne kemi propozuar që kjo tarifë të ndahet, pra në sezonin veror të jetë 75% e pagesës, ndërsa sezoni dimëror 25% e pagesës. Ata të cilët dëshirojnë t'i shfrytëzojnë gjatë gjithë vitit, do ta kenë tarifën e njëjtë si më parë, ndërsa ata të cilët do ta shfrytëzojnë vetëm gjatë verës, do ta kenë 75% të pagesës së mëhershme. Sa i përket vendosjes së çadrave, kemi dhënë propozim

që të merret vendim për t'u hequr nga pagesa, ndërsa të futen në pagesë ato të cilat kanë reklamë. Përveç këtyre ndryshimeve, kemi propozuar që ndryshime të bëhen edhe në vendosjen e panove, ekspozimi i reklamave në automjete, kompanitë të cilat shpërndajnë mallra, për tabelat informuese për hotele, për këto kemi paraparë që të shtohen tarifa shtesë.

**Kryetari** i njoftoi të pranishmit, duke u shprehur se kemi kërkuar ndryshimin edhe lirimim nga taksa administrative për familjet e dëshmorëve, të invalidëve të luftës, të personave me aftësi të kufizuara, prindërit dhe fëmijët e mitur të ish-të burgosurve politikë të vdekur, rastet sociale, veteranët e luftës dhe ish-të burgosurit politikë që nuk kanë qenë të përfshirë më herët.

**Sokol Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar këtë propozimrregullore dhe pajtohemi me disa paragrafë dhe nënparagrafë, siç është paragrafi 1.3 dhe 6,9, të cilët i mundësojnë komunitetit të biznesit një çmim shumë më të arsyeshëm sesa që ka qenë deri më tani dhe, në një mënyrë, kjo e lehtëson mbijetesën e tyre në treg. Por, në asnjë variant nuk pajtohemi me propozimet e dhëna, sidomos në paragrafin 6.12, ku ka një rritje enorme, në paragrafin 6.15, që është më i ultë, në paragrafin 6.16, që është 53,8% në rritje, në paragrafin 6.17, ku ka ulje, që është i pranueshëm, paragrafi 6.20, kemi të bëjmë me 500% rritje, në paragrafin 6.21, që kemi të bëjmë me 250% rritje. E njëjta është te paragrafët 6.22 dhe 6.23, që është 350% rritje. Marr parasysh gjithë këto që u cekën, mendojmë që kjo rritje është joreale, andaj ne propozojmë që të mbeten ashtu siç kanë qenë deri më tani.

**Ylli Hoxha**, në emër të GP të LVV-së, tha se edhe ne e kemi analizuar këtë propozim çmimore të re dhe konsiderojmë se ka logjikë secili prej propozimeve. Nuk mund të kërkojmë rritje të buxhetit të Komunës, nëse, në një anë, ia këpusim buxhetin prej nivelit qendror dhe, në anën tjetër, refuzojmë çdo arkëtim brenda qytetit, i cili është normal. Nuk jemi duke kërkuar ngarkimin e një kompanie që ka afarizëm të vështirë, është kompani e vogël, por zakonisht janë kompanitë e mëdha. Reklama është çështje e dëshirës së kompanisë, por nuk mund të ketë biznes të vogël e reklamë të madhe. Konsiderojmë se duhet të ekzistoj një standard i taksave, i cili është ekuivalent me qytetet e rajonit. Në këtë drejtim ne e përkrahim për miratim.

**Lirak Çelaj**, në emër të GP të PDK-së, theksoi se qysh në fillim ne propozuam që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, sepse konsiderojmë që është një rritje e madhe dhe e panevojshme. Konsideroj që tarifatat shumë të larta e ngarkojnë dhe e rëndojnë shumë biznesin, pra nuk do të ishte mirë ta ngarkojmë asnjë biznes.

Pajtohem me heqjen e bilbordeve dhe reklamave, sepse është ngarkuar qyteti shumë dhe është shëmtuar, por ato që janë, mos të jenë shumë të shtrenjta. Njëherësh kërkoi që në këtë rregullore të parashihen tarifatat sipas zonave.

**Remzi Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, shprehu mendimin se ngritja e këtyre tarifave është jashtë norme, pra në këtë formë e ngarkojmë edhe aq më shumë biznesin. Një ngritje do të ishte e arsyeshme me një përqindje çfarë mund të bëhet për momentin, por një ngritje të tillë nuk mund ta parashohim dhe nuk do ta votojmë.

**Fadil Gashi**, në emër të GP të AAK- LDD-së, e përkrahu propozimin e drejtorit të drejtorisë përkatëse për ndryshimin e tarifave.

**Kimet Zeqa**, në emër të GP të PD-së, e përkrahu këtë propozim për ndryshim e tarifave.

**Abetare Fazliu**, në emër të GP të LB-së, tha se edhe ne e përkrahim vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, për shkak të lehtësimit të disa ndryshimeve për qytetarë, sidomos tek neni 2, paragrafi 1.

Lidhur me propozimin për ndryshimin e tarifave, sqarime shtesë dha **Dardan Sejdiu**, nënkryetar i Komunës.

**Sami Hamiti** theksoi se neni 6.9 dhe neni 2 i rregullores, faktikisht kreu i dytë është në rregull dhe se tarifat për bizneset kanë qenë të larta, andaj dhe është propozuar që këto të ulen, faktikisht dhe janë ulur. Po t'i krahasojmë këto tarifa me vendet e rajonit, mund të konstatojmë se janë shumë të larta, andaj pjesën e parë të kësaj rregulloreje, gjegjësisht kreun e dytë dhe të tretë, deri te neni 6.11 dhe 6.9, i përkrahim se janë në rregull, ndërsa pjesa tjetër është jashtë çdo norme.

**Ardian Gashi** tha se çadrat ose restorantet të cilat kanë reklama të tyre, janë të detyruar t'i paguajnë tarifën, sepse e shfrytëzojnë hapësirën publike.

**Abit Kastrati** u shpreh se nuk jemi kundër pagesave të reklamave, por duhet të kihet parasysh se sa fiton një biznes, andaj me këto çmime do të bëhet ngufatja e bizneseve të tjera, të cilat janë të gatshme ta bëjnë edhe ato një lloj reklame. Këto propozime për ndryshimin e tarifave duhet t'i analizojmë, vërtetë të ndalemi dhe të mendojmë që mos t'i ngarkojmë shumë bizneset.

**Remzi Pacolli** pyeti se a ka të drejtë lokali që e vendos çadrën, ta ketë reklamën e vet në çadër dhe ajo të jetë pa pagesë? Edhe vendosja e reklamave në furgona, nëse një kompani i ka 20 furgona të vetë, që i ka reklamat e veta nëpër ta dhe shëtitet?

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga z. Pacolli, sqarime shtesë dha **Ardian Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

**Shefki Gashi** tha se këto tarifa që po propozohen, për një pjesë të bizneseve janë të pa përballueshme, andaj do të ishte mirë që kjo rregullore të përpunohet edhe më tej, të jetë sa më ekonomike dhe e përshtatshme për qytetarin.

**Kryetari** propozoi që ky propozimvendim të shkojë me pikat 1, 2, 3, edhe pika 12, e cila është për tabelë. Të tjerat mbeten që të rishikohen edhe njëherë.

**U konstatua se njëzëri, pjesërisht u miratua propozimi për ndryshimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.**

## **Pika e dhjetë**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e Komisionit për përcjelljen e procedurës për zgjedhjen e këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, Kryetari tha se duhet ta formojmë një komision, i cili do të merret tash e tutje, gjatë këtij mandati, me procedurat e përzgjedhjes së këshillave të fshatrave të BL-ve.**

Për anëtarë të këtij komisioni u propozuan: Shefki Gashi (LDK), Qëndron Kastrati (LVV), Muhamet Selmani (PDK), Sofije Bunjaku (AKR) dhe Fadil Leci, zyrtar komunal.

**Njëzëri u miratua Vendimin për formimin e komisionit për përcjelljen e procedurës për zgjedhjen e këshillit të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.**

**Pika e njëmbëdhjetë dhe e dymbëdhjetë.  
Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme.**

**Lirak Çelaj** tha se në një mbledhje të mëhershme e kemi marrë një vendim për rishqyrtimin e çështjes së pronës këtu te xhamia, që është afër Kuvendit. Tash e sa ditë ata qytetarë i kemi në protestë. A mund ta dimë si është procedura, ku ka mbetur procedura, çka ka ndodhur, çka do të ndodhë dhe kur kanë me e ditur ata çka po ndodhë, në cilën datë? Besoj se ata duhet të informuar lidhur me këtë.

**Ajnishahe Azemi** shtroi pyetjen: Çka do të bëhet me nxënësit e komunës së Prishtinës, të cilët edhe pse i kanë plotësuar kriteret për t'u pranuar në shkollat e mesme, nuk janë pranuar, për shkak të pranimit të nxënësve nga komunat tjera, por edhe për shkak të kufizimit të numrit të nxënësve që mund të pranohen në shkolla?

Pyetja tjetër: A ka mundësi, që të rritet numri i nxënësve të pranuar në klasë deri në 40 nxënës, në mënyrë që t'u mundësohet edhe nxënësve të tjerë, të cilët i plotësojnë kriteret, për të qenë nxënës të shkollave ku kanë aplikuar dhe të pranohen nxënësit, të cilët janë në vazhdim të listës së rezultateve të nxënësve të pranuar?

Pyetja e radhës: A ka mundësi që ju, Kryetar, dhe Drejtoria e Arsimit e Komunës sonë, të ndikoni te Ministria e Arsimit për hapjen edhe të dy paraleleve, për klasat e dhjeta, në gjimnazin "Xhevdet Doda", sepse i kemi dy klasë të zbrazëta, të cilat nuk shfrytëzohen.

**Sylejman Pireva** theksoi se në seancën e fundit kam shtruar çështjen vitale, zvarritjen e pakufi të lëshimit në punë të objektit të bibliotekës "Hivzi Sylejmani" të Prishtinës, dhe kam marrë zotimin se në këtë seancë do të jepet një informatë lidhur me këtë. Kërkoj, që kjo informatë të mos mbetet interne vetëm për asamblistët, por le të bëhet publike, për krejt opinionin, çfarë është duke ndodh vërtetë me këtë objekt, që po zvarritet kështu në mënyrë çoroditëse.

**Kimete Zeqa, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit:**

Kërkoj të dijë se deri në orën sa në mbrëmje, 23 apo 24, edhe gjatë të dielave apo ditëve tjera, a është e lejueshme dhe sa është e lejueshme zhurma në lokale?

Pyetja e dytë ka të bëjë me një hapësirë për parking, e cila gjendet prapa policisë, gjegjësisht përballë kafenesë "Tingëll- Tangëll", ku ne qytetarët nuk kemi qasje në atë parking. Kërkoj që për këtë çështje të bëhet një zgjidhje në të ardhmen.

**Agim Gashi, pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:**

A ka planifikuar kjo drejtori që t'i inkorporojë në sistemin e dezinfektimit fshatrat e komunës, siç janë: Hajvalia, disa lagje të Mramorit, Llukari, Siqeva, Rimanishta, Barileva etj.?

**Mirlinda Sopi** tha se me që jam pjesë e një grupi, përmes EMBIA-it dhe USAID-it, po përpiqemi për një iniciativë për zvogëlim të mëtejme të numrit të nxënësve nëpër klasa. Tash për tash është Udhëzimi administrativ 22/2013, që e përcakton 32-35 numrin e nxënësve në klasa. Andaj ta përkrahim këtë iniciativë për ndryshim të këtij Udhëzimi administrativ, për zvogëlimin e numrit të nxënësve prej 25-30 nxënës në klasa, sepse njëra prej arsyeve pse është cilësia e dobët e mësimin, është numri i madh i nxënësve.

**Pyetja e dytë** është: Disa qytetarë të lagjes "Kodra e Trimave", ku janë më se 46 kryefamiljarë, 46 shtëpi, ata banorë janë shumë të shqetësuar, pasi që komuna pas 40 viteve kërkon që këto shtëpi të kenë leje. Çfarë duhet bërë dhe cila është rruga që duhet ta ndjekin?

**E treta:** Në fshatin Hajvali, gjegjësisht në lagjen “Ragip Loxha”, janë dy rrugë, të cilat janë të emëruara me po të njëjtin emër. Qytetarët kanë kërkuar që të bëhet një zgjidhje, që të mos emërohen me të njëjtin emër të dy rrugët.

**Sokol Krasniqi, kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit:**

Kërkoj nga kjo drejtori që të marrë masa për sanimin e rrugës Kolovicë- Butovc, pasi që pas shirave të fundit është degraduar në atë masë, sa që është bërë e pakalueshme.

**Pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale:**

A ka mundësi që kjo rrugë ( Kolovicë - Butovc) të futet në projekt për asfaltim, pasi që është një ndër vendet më të bukura që ka komuna e Prishtinës?

**Lirije Avdiu, pyetje për Kryetarin e Komunës:**

Z. Kryetar, në njërën prej mbledhjeve të këtij Kuvendi, ju e sollët propozimin për shitjen e veturës së ish-kryetarit, andaj shtroj pyetjen: Pse gjatë fushatës u përdor ajo shitje dhe çka ka ndodhë me atë veturë, a është shitur apo jo, nëse po, atëherë mjetet a janë destinuar aty ku ka qenë e paraparë?

**Remzi Pacolli, pyetje për Drejtorinë e Administratës**

Kërkoj nga drejtori përkatës që të na mundësohet qasja në parkingun e Komunës gjatë ditës kur kemi mbledhje të Kuvendit.

**-Pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit:**

Janë disa rrugë në fshatin Hajvali që nuk kanë ndriçim, pyes: A do të jetë ndonjë projekt për ndriçimin e këtyre rrugëve në Hajvali, a është paraparë diçka në këtë drejtim?

**Shaip Hajrizi parashtrori disa pyetje:**

Janë disa rrugë, rrugica në lagjen “Kodrën e Trimave”, që janë diku rreth 20, por janë aq të shkurta sa që gjithsej nuk bëhen 2 apo 2.5 km. A pritet të asfaltohen sivjet, sepse qytetarët janë të interesuar vazhdimisht? Gjithashtu rrugët e fshatrave Keqekollë dhe Koliq, janë shtruar me zhavorr. A pritet edhe këto të përfshihen në projekte për asfaltim, sepse edhe ashtu nga shirat këto veç janë dëmtuar shumica?

Në këtë lagje janë shumë rrugë pa ndriçim. A do të ketë ndonjë projekt për ndriçimin e tyre dhe për sanimin e gropave?

**Pyetje për Drejtorinë e Pronës:**

- A ka mundësi Drejtoria e Pronës t’i lejojë gjeometrat të dalin në terren dhe ta bëjnë matjen – incizimin e rrugëve, pasi që pronarët janë të gatshëm të bëjnë shpronësimin e rrugicave?

**Teuta Krasniqi, pyetje për Drejtorinë e Arsimit:**

Profesorët e Gjimnazit, të cilët mbajnë gjithherë kujdestari në këtë shkollë, deri më sot nuk janë paguar asnjëherë. Kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit të na japë një përgjigje.

**Lirijeta Rexhepi** edhe kësaj radhe ngriti çështjen e lirimit të rrugës në lagjen “Velania”, e cila tha se te shtëpia e ish-Presidentit, Ibrahim Rugova, dyert e vendosura në rrugë çelen përkohësisht dhe rrinë mbyllur gjatë gjithë kohës, ku me të vërtetë e kanë vështirësuar jetën e banorëve të asaj lagje. Kërkoj të dijë nga Kryetari se kur kanë me u zhvendosur ato dyer.

**Merita Surkishi** shtroi pyetjen rreth vendosjes së tavolinave para lokaleve. Ajo pyeti se a duhet të plotësojnë këto subjekte ndonjë kusht, duke e pas parasysh se disa nga këto lokale veç janë duke i shfrytëzuar trotuaret, duke penguar qarkullimin e lirë të qytetarëve, si në rrugën “Garibaldi”, rruga te Kinemaja”ABC” etj.



Po ashtu tha se në lagjen “Kodra e Trimave”, gjegjësisht para shtëpisë sime, është një trotuar i pa rregulluar, i cili më pamundëson qasjen me veturë në shtëpinë time. Gjithashtu është shqetësuese se ky trotuar i parregulluar është pengesë edhe për lëvizjen e lirë të nxënësve.

**Ajnishahe Azemi**, në emër të qytetarëve të lagjes “Kodra e Trimave”, përshëndeti fillimin e punimeve për ndërtimin e një parku në gropën e dheut te ish-Fabrika e tjegullave.

**Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:**

Banorë e fshatrave Sharban dhe Besi vitin e kaluar i kanë dorëzuar kërkesat për ndërtimin e dy qendrave rekreative-sportive. Deri ku ka arritur procedura për ndërtimin e tyre?

**Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, Kryetari dha këto informata dhe sqarime:**

- Sa i përket vizitës në Bullgari, tha se ajo ka qenë një vizitë zyrtare dhe ka pasur një agjendë të caktuar.

- Për gjendjen në lagjen “Dodona”, tha se aty është një problem i jashtëzakonshëm dhe për momentin nuk po mundet të bëhet zgjidhje, sepse investitori prej momentit që e kemi marrë ne mandatin, ua ka zvogëluar pagesat që i kanë pas, qe tri vjet ua ka dhënë një shumë të caktuar, tash ua ka ndarë përgjysmë dhe i ka shti këta në presion të jashtëzakonshëm, për t’ua bërë një zgjidhje apo tjetër. Po ashtu në këtë hapësirë ka edhe problem të tjera pronësore, që në fakt e bëjnë të pamundur zgjidhjen e këtij problemi.

- Sa i përket Bibliotekës, objekti ku pritet të jetë Biblioteka, edhe përkundër një pranimi teknik që është bërë, ajo prapë nuk i plotëson kushtet për një destinim të tillë, andaj këtë çështje do ta diskutojmë edhe stafin e Bibliotekës, se a do të pranojnë që të vendosen në këtë objekt.

- Për lagjen “Kodra e Trimave”, tha se për këtë hapësirë ku kërkohet nga Komuna leje për shtëpitë e ndërtuara, për këtë çështje kemi formuar një komision, i cili do të bëjë verifikimin e gjithë pronës komunale.

- Sa i përket emërtimit të rrugëve në fshatin Hajvali, tha se me ligj është e ndaluar që dy rrugë ta kenë të njëjtin emër, andaj kjo do të merret parasysh.

- Sa i përket veturës Audi Q 7, shitja e saj është në procedurë e sipër, tani veç është në fazën e fundit, sepse është një procedurë e komplikuar e prokurimit.

- Për çështjen e problemeve me trotuare, tha se jemi në hulumtim të gjetjes së një alternative ku, para se gjithash, po mundohemi që disa nga zebrat t’i ngremë në nivel të trotuarit, sepse vetëm me pengesat “polic i shtrirë” nuk po bëhet zgjidhje.

- Sa i përket zënies së trotuareve nga lokalet, tani kemi filluar lirimin e tyre, duke bërë konfiskimin e tavolinave dhe karrigeve.

- Për lirimin në qarkullim të rrugës në lagjen “Velania”, tha se përderisa më herët është marrë një vendim për hapjen e kësaj rruge, mendoj se së shpejti do të bëhet hapja e saj.

Lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna të parashtruara nga parafolësit, e të cilat kishin të bënin rreth numrit të nxënësve nëpër paralele të shkollave të mesme, si dhe regjistrimin e tyre, të pranishmit i njoftoi **Jusuf Thaçi**, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

Për pyetjet e parashtruara që kishin të bënin rreth projekteve në infrastrukturën rrugore, të pranishmit i njoftoi **Hysen Durmishi**, drejtor i Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale.

Për pyetjet e parashtruara që kishin të bënin rreth dezinfektimit dhe dezinfektimit të ambientit, konkretisht në ato zona ku ka pasur vërshime, informoi **Arben Vitija**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Për pyetjet e parashtruara që kishin të bënin lidhur me ndërtimin e terreneve sportive në Sharban dhe Besi, informoi **Blerta Zeqiri**, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Rinis dhe Sportit.

Lidhur me çështjet e ngritura që kishin të bënin me zhurmën nga lokalet- kafiteritë në qytet gjatë natës, si dhe për ndriçimin e rrugëve në Hajvali dhe në lagjen "Kodra e trimave", informoi **Ardian Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Lidhur me ndërtimet e parkingjeve informoi **Dardan Sejdiu**, nënkryetar i Komunës. Ai i njoftoi të pranishmit se, në bashkëpunim me ndërmarrjen publike komunale përkatëse, në fillim të muajit tetor, të gjitha parkingjet në Zonën 1 - Qendër, do të jenë të rregulluara, qoftë me sinjal, qoftë për pagesë, qoftë me ndarje për banorë të lagjeve.

**Agim Gashi** ngriti një shqetësim, duke thënë se në bashkëpunim me Drejtorinë e Aarsimit dhe Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dy herë e kemi thirrur mbledhjen e Komitetit për arsim dhe kulturë. I lus anëtarët e komitetit që t'i përgjigjen thirrjes për mbledhje të rregullta.

**Mbledhja mbaroi në orën 16:00.**

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**